

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" ERSA - DEINA 2017 " SH.P.K

Sot me datën 08/08/2017 Z.Zamir Veliu , I biri i Shaqirit i datëlindjes 14.12.1983 dhe banues në Fier , shtetas shqipëtar i identifikuar me letërnjoftimin me nr 028059381 dhe numrit personal I31214048U , madhor me përgjegjësi të plotë juridike për të vepruar ka vendosur të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar ERSA - DEINA 2017 Sh.P.K .Me vullnetin e tij të lirë harton statusin dhe aktin e themelimit

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike , Selia Kohëzgjatja , Vula

Neni 1

Formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ERSA - DEINA 2017 Sh.P.K me ortak të vetem themelues z.Zamir Veliu.Ne bazë të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare"

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar dhe do të përballoj humbjen deri ne kufirin e kontributit te themeluesit të saj në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë ne adresën Fier Lagja "15 Tetori " Rruga "Kastriot Muça" godina nr.3.Ajo mund të cele edhe seli te tjera te dyta , mund të ndryshoj selinë me vendim të ortakëve, mund të hapë filial , përfaqësi dhe agjensi operative në te gjithë territorin e RSH dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashtë saj.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ketë kohëzgjatje të veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar , dhe e fiton personalitetin e saj juridik nga moment i rregjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen ERSA - DEINA 2017 Shpk.

KREU II

Neni 6

Objekti I Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë në fushën e këmbimit të valute..Ushtrimin e veprimtarisë së transferimit të parave në emër dhe për llogari të subjektit financiar jo bank Ak Invest dhe Money Gram.Shoqëria mund të ushtroj gjithashtu dhe aktivitete të tjera plotësuese dhe ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të shoqërisë.



KREU III
KAPITALI
Neni 7

Kapitali themeltar I shoqërisë është me vlerë 2.500.000 lekë (dy million e pesëqind mijë lekë) që I koresponдон një kuote dhe përbëhet nga kontributi I ortakut të vetëm si më poshtë

Z.Zamir Veliu është zotërues I një kuote të kapitalit themeltar me një vlerë prej 2.500.000 lekë (dy million e pesëqind mijë lekë).Ky capital do të ngurtësohet ne bankë mbasi shoqëria të rregjistrohet ne QKB.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjct nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontribut në para dhe me anë të kontributeve në natyrë . Në asnjë rast shumica nuk mund të detyroj një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar shoqërisë . Zvogëlimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendim ne të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statusit .

Në të gjitha rastet zvogëlimi I prek ortakët në të njëjtën masë të pjesës së kapitalit që përfaqësojnë por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën nivelin e kapitalit themeltar..

Neni 9

Transferimi I shoqërisë

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet

- a) Kontributin në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj

Në rastin e kalimit te kuotave me kontratë , kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky status kushtëzon të drejtën ë kalimit të kuotave te tretëvë jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe me të drejtën ë parablerjes në favor të shoqërisë ose të ortakëve sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimin e statusit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e perfiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi I kuotës ,nga casti I kalimit të kuotës deri në castin e rregjistrimit te kalimit të saj në Qëndrën Kombëtrae të Biznesit sipas nenit 43) te Ligjit 9723 datë 03.05.2007 Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit .Rregjistrimi I kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të trasferueshme ndërmjet ortakeve.
Pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRIMI, KONTROLLI

Neni 10- Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas nenit 83 dhe 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 11- Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.

Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes

Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga: 1. Kryetari; ose 2. një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.

Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë nëlidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 12: Votat e Ortakëve

Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin



kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (ne rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 13- Votimi me Prokurë

Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës që miratohet nga Administratori i shoqërisë ose prokure përfaqësimit.

Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë, duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 14- Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Neni 15- Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta dhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e zakonshme. Administratori/et qëndrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiare, me mundësi për tu rizgjedhur.

Administratori/et kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhenie me të tretet, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti ja jep Asamblese së Ortakëve.

Administrator i shoqërisë është Z. **ZAMIR VELIU** për një afat 5 (pesë) vjetar. Ajo do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 16- Ekspertët Kontabel të Autorizuar.

Shoqëria do të kontrollohet nga një ose disa eksperte kontabel të autorizuar të zgjedhur nga lista e Institutit të Eksperteve Kontabel të Autorizuar. Në caktimin e eksperteve kontabel të autorizuar mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtushmeritë e percaktuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Eksperti/et kontabel të autorizuar emërohen nga asambleja e përgjithshme, në afatet e parashikuara nga ligji, me të drejtë rizgjedhje në kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një



shumicë të zakonshme.

Detyrimet dhe te drejtat e Eksperteve Kontabel te Autorizuar te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Raportet qe ata pergatisin depozitohen ne seline e shoqerise, ne afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 17- Viti financiar dhe bilanci vjetor.

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar, prane Qendes Kombetare te Rregjistrimit, dhe perfundon ne 31 dhjetor te te njejtit vit.

Pasqyrat financiare,raporti i administrimit dhe raporti i ekspertit/ve kontabel te autorizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme ne kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme.

Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

Neni 18- Dividendët

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve nëpërputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë ecaktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndajshoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data ematurimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 19- Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

KAPITULLI I V

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 20- Prishja, Likujdimi

Perjashtuar rastin e nje prishje me vendim gjyqi e parashikuar nga ligji, shoqeria mund te priset ne çdo kohe, me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme.

Perveç rastit te bashkimit ose te ndarjes, prishja e shoqerise per cfardo shkak qofte sjell likujdimin e saj. Likujdimi kryet nga nje ose disa likujdatore te emeruar nga Asambleja, te cilet kryejne kete detyre ne perputhje statutin e shoqerise, ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe kerkesat e tjera ligjore.

Likujdatori perfaqeson shoqerine. Ai ka kompetenca te plota per te shitur aktivet e shoqerise, per te shlyer kreditorët dhe per te shperndare mbetjen e disponushme ne perpjestim me pjeset e ortakeve ne kapitalin e rregjistruar.

Me perfundimin e procedures se likujdimit te Shoqerise, Asambleja do te vendose, me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave, mbi bilancin financiar perfundimtar mbi vlefshmerine e punes se kryer nga likujduesit dhe mbi perfundimin e procesit te likujdimit.

Neni 21- Transformimi i Shoqerise.

Shoqeria mund te ndyshoje formen e saj ligjore nepermjet shnderrimit, ne perputhje me kerkesat e nenit 228 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me vendimin të Asamblesë së Përgjithshme te marrë me shumicën e kualifikuar së votave.

Neni 22-Kundershtimet

Te gjitha kundershimitet ose mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likujdimit te saj, midis ortakeve ose nje apo me shume prej tyre dhe shoqerise, do te diskutohen ne menyre te drjetperdrejte midis te interesuareve per ti zgjidhur miqesisht. Ne rast te kundert i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

Neni 23- Shpenzimet.

Te gjitha shpenzimet e kryera perpara firmosjes se statutit dhe ato midis dates se firmosjes se statutit e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar, jane shpenzime qe do perballohen nga shoqeria.

Neni 24- Te tjera

Ky statut eshte pergatitur ne kater kopje dhe eshte nenshkruar nga themeluesit me **08.08.2017**

ORTAKU THEMELUES

ZAMIR VELIU

